



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1154/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Klan Kosova Sh.p.k me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve-Prishtinë, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini Sh.p.k me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike anulimi i aktvendimit me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të paditurës nr.4566/01 i dt. 28.07.2023 dhe vendimit 309/11 i dt. 14.06.2023, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.315/23 të datës 02.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, ka aprovuar kërkesën e paditësit Klan Kosova Sh.p.k me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatoreve, në Prishtinë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të paditurës, si dhe ka vendosur të shtyhet ekzekutimi i Vendimit nr.4566/01 i dt. 28.07.2023 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve si dhe Vendimit nr. 309/11 i dt. 14.06.2023 i nxjerr nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata të aprovoj ankesën si të bazuar, të prishet aktvendimi KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023 i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative si dhe të refuzohet në tersi si e pabazuar kërkesa e paditësit Klan Kosova Sh.p.k me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatoreve, Prishtinë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.4566/01 i dt. 28.07.2023 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit 309/11 i dt. 14.06.2023 i nxjerr nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e të paditurës dhe i ka propozuar Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale që të refuzohet në tersi ankesa e të paditurës si e pathemeltë dhe të mbetet në fuqi vendimi KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së të paditurës, kolegji i kësaj gjykate gjen se, gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të paditurit nr.4566/01 të dt. 28.07.2023, dhe vendimit nr.309/11 i dt. 14.06.2023 ka gjetur se ekzekutimi i vendimit kontestues, paditësit do ti sillte dëm vështirë të riparueshëm, ndërsa shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik. Propozuesi pretendimet e paraqitura në propozim i ka mbështetur në argumente të mjaftueshme. Gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA).

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret, janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike, është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditurës në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu refuzuar propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Në rastin konkret kolegji i kësaj gjykate e pranon përfundimin e shkallës së parë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës, për shkak se Dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se paditësi-propozuesi e ka mbështetur në argumente të mjaftueshme faktin se ekziston rreziku se me ekzekutimin e vendimit kontestues, paditësit do ti shkaktohet dëm i pariparueshëm pasi që me pezullimin e certifikatës së biznesit, paditësi nuk mund të ushtroj veprimtarin ekonomike, rrjedhimisht do të rezultojë edhe me revokimin e licencën nga Komisioni i Pavarur për Media për ushtrimin e funksionit të ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuale. Si rrjedhojë do të kishte për pasoj ndërprerjen e marrëdhënies se punës për rreth 220 punëtor si dhe me ndërprerjen e marrëdhënieve tjera kontraktuale me palët e treta, rrethana këto që në rast të ekzekutimit të vendimeve kontestuese paditësit do ti sillnin dëme vështirë të riparueshme.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se Dhoma e shkallës së parë në vendimin e atakuar ka pasqyruar gjendjen faktike në tërësi përmes provave materiale të ofruara nga paditësi siç është lista e pagave të punëtorëve, për gjithsejtë 220 punëtor dhe në rast të ekzekutimit të vendimit të paditurës ekziston mundësia e shkakimit të dëmeve përkatësisht ndërprerjen e marrëdhënies se punës për te punësuarit tek paditësi, dhe për të cilat arsye shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur është i domosdoshëm dhe se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparueshëm për paditësin, gjersa shtyrja nuk do ti sillte dëm të madh palës kundërshtare.

Pretendimet e të paditurës në ankesë për shkeljet e pretenduara nga Dhomat e shkallës së parë, kolegji i kësaj gjykate i refuzon si jo të bazuara në prova konkrete për të vendosur ndryshe në këtë çështje sepse nuk dëshmohet se vendimi i ankimuar është nxjerrë me shkelje të dispozitave ligjore. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës është cenuar interesi publik, kolegji konsideron se ky pretendim është i pambështetur në argumente bindëse dhe si i tillë nuk qëndron, pasi që nga ana e palës së paditur nuk u provua cenimi i interesit publik.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nuk i pranoi si të bazuara pretendimet në ankesë për arsye se, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, ka vlerësuar faktet në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 22 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative. Kolegji, vlerëson se pretendimet ankimore nuk ndikojnë në ndryshimin e një gjendje tjetër faktike që i ka konstatuar shkalla e parë. Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të ankuesit në ankesë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë të mbështetura

në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritorë pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin ndryshe në këtë çështje juridike administrative.

Kolegji, pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm, se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kolegji gjen se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të propozimit të paditësit-propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të paditurit, dhe se nuk është cënuar ligji në dëm të ankuesit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar i Dhomave të Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i kësaj gjykate. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1154/23 me datë 07.09.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi